



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 58

Prishtinë, më 19 shtator 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi- kryetar i Komisionit, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Amir Ahmeti, Mufera Şinik dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Behar Selimi dhe Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE; Lumnije Murati – ZPRK; Isuf Zejna dhe Besnik Ramadanaj – KDI; Arton Demhasaj – Çohu; Besnik Ramadanaj – KDI; Agon Vrenezi – OHCHR; Vlora Marmullakaj, Artan Canhasi – EULEX; Sylë Ahmeti – Kosova sot; Visar Smajlaj – ekspert; Arben Shamolli – ISKP dhe Shkëlzen Gerxhaliu – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 27 dhe 31.08.2012;
3. Shqyrtimi i raportit plotësues të KQZ-së;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për provimin e jurisprudencës;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës, me amendamentet e propozuara nga grupi i punës;
7. Shqyrtimi i propozimit për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që si pika të rendit të ditës të radhiten edhe:

- Formimi i grupit të punës për Projektligjin për procedurën përmbartimore;
- Shqyrtimi i detyrave nga plani i veprimit për tremujorin e tretë.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara nga kryetari i Komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 27 dhe 31.08. 2012

Albulena Haxhiu – Kishte vërejtje në procesverbalin e datës 31. 08. 2012, kur është biseduar për Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Ajo kërkoi që të përfshihet diskutimi i plotë. “Në kohën kur korrupsioni po rritet si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë sjell një ligj, i cili as për së afërmi nuk e lufton korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ajo konsideroi se kompletimi i pakos ligjore kundërkorrupsion, është më se e domosdoshme. Pra, edhe ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, por edhe Ligji antimafia, janë ligje shumë të rëndësishme, prandaj para se të miratojmë shumë ligje të panevojshme, ne duhet të kompletojmë pakon ligjore kundërkorrupsion. Ajo theksoi se Ministria e Drejtësisë nuk i ka marrë parasysh rekomandimet e shoqërisë civile, ndërsa pati vërejtje edhe në vetë titullin e këtij ligji, që sipas saj, do duhej të ishte “Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme”. Ajo gjithashtu përkrahu idenë se barra e provës duhet të jetë tek i dyshuari, pasi kjo rrit mundësinë e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sa i përket fuqisë së retroaktivitetit, ajo tha se duhet të merren modele nga shtetet, si: Shqipëria, Sllovenia dhe Bullgaria, shtete të cilat kanë infrastrukturë ligjore, që realisht e lufton korrupsionin. Gjithashtu, deputetja Haxhiu ngriti çështjen se çfarë do të bëhet me pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme, e cila ka dalë jashtë territorit të Kosovës, pasi ligji në fjalë nuk e rregullon këtë çështje, prandaj duhet të krijohen dispozita të reja, të cilat e rregullojnë atë.

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e datës 27.08.2012, pa vërejtje, kurse procesverbalin e datës 31.08.2012, me vërejtjen e Albulena Haxhiut.

3. Shqyrtimi i raportit plotësues të KQZ-së

Albulena Haxhiu – Theksoi se KQZ-ja edhe njëherë është treguar joserioze në raport me Kuvendin e Kosovës dhe Komisionin për Legjislacion, pasi që ata kanë kërkuar procedurat se si është zgjedhur ushtruesja e detyrës z. Miradije Mavriqi, pastaj edhe transformimin e z. Peqani nga pozita e kryeshefit ekzekutiv të Sekretariatit, në një zyrtarë të thjeshtë ligjore, vendime të cilat ajo i konsideroi pa bazë ligjore. Edhe në shkresën që KQZ-ja ka sjellë në Komision, vërehet se ka shumë shkelje, sikurse rasti kur kërkohet risistemimi i kryeshefit ekzekutiv në një pozitë tjetër, dhe kjo ndodhë pa shpalljen e një konkursi, siç parashihet me Ligjin për shërbyesit civilë. Gjithashtu, më datën 09.11, në të njëjtën mbledhje, KQZ-ja emëron Miradije Mavriqin si ushtruese e detyrës së kryeshefit ekzekutiv të KQZ-së,

përkundër faktit se KQZ-ja nuk ka të drejtë të emërojë ushtrues detyre, ndërkohë që zgjedhja është bërë më 09.11.2011, e që vazhdon ende të mbajë këtë pozitë, edhe pse një ushtrues detyre nuk mund të mbajë pozitën më gjatë se 6 muaj. Në fund, deputetja Haxhiu kërkoi që të mos miratohet raporti i KQZ-së.

Ardian Gjini – Në fakt, raporti paraqet gjendjen e KQZ-së dhe mosmiratimi i raportit do nënkuptonte mosparaqitjen apo ndryshimin e fakteve. Gjithashtu, mosmiratimi i tij nënkupton që KQZ-ja duhet sjellë një raport tjetër, i cili do ishte i njëjti, prandaj duhet ta miratojmë këtë raport me disa rekomandime nga Komisioni rreth parregullsive dhe shkeljeve, disa prej të cilave janë skandaloze. Ai propozoi që raporti të kalojë dhe Komisioni të dërgojë konkluzione dhe rekomandime edhe për Kuvendin e Kosovës, për KQZ-në dhe për gjitha institucionet tjera relevante, të cilat mund të merren me këtë çështje.

Armend Zemaj – Tha se informatat shitesë rreth raportit janë kërkuar për dy arsye: e para është se nuk është i kënaqur me punën që ka bërë KQZ-ja, sidomos organizimi, përcjellja dhe menaxhimi financiar i zgjedhjeve të vitit 2010. E dyta është fakti se si një zyrtar mund të kërkojë uljen e pozitës nga kryeshefi ekzekutiv në një zyrtar të thjeshtë ligjor, gjë që bën të dyshojmë për punën e tij, sidomos kur kemi parasysh faktin se ai mbante pozitën e kryeshefit ekzekutiv gjatë zgjedhjeve të vitit 2010, zgjedhje në të cilat kishte vjedhje sistematike të votave. Ai ishte për miratimin e raportit, mirëpo me rekomandimet e propozuara.

Kryetar konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet Raporti i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për 2011.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Arsim Bajrami – Kishte dy vërejtje parimore, njëra nga të cilat ishte çështja e njohjes së këtij provimi për njerëzit me titull shkencor “doktor”, të cilët gjithashtu kanë 5 vite përvojë pune në administratë, gjë që është inkompatibile për faktin se kjo nuk garanton zotërim të mirëfilltë të individit në fushën e gjyqësisë apo prokurorisë. Çështja e dytë është se në pjesën e dytë ku përcaktohet se provimin ka të drejtë ta paraqesë secili që ka përvojë pune 1 vjeçare në gjyqësi, duhet të shtohet edhe fusha e noterisë.

Amir Ahmeti – Kishte vërejtje tek neni 11, pika 8, pasi fillimisht në nenet tjera përcaktohet që dhënia e provimit varet nga grumbullimi i pikëve në test, kurse në këtë nen përsëri i jepet kompetencë komisionit që me shumicë votash të përcaktojnë kandidatët të cilët japin provimin, përkundër faktit që kjo është përcaktuar më herët nga rezultati i provimit, të cilit i janë nënshtruar ata.

Armend Zemaj – Mbështeti gjetjet e bëra nga deputeti Ahmeti, duke theksuar se kompetenca e Komisionit për provimin e jurisprudencës, është keqpërdorur disa herë nga profesorë të caktuar, me qëllimin që të neglizhohet avancimi i gjeneratave të reja, duke iu mundësuar atyre siguri në pozitë e

tyre, të cilat i mbajnë tash e sa vite. Gjithashtu, ai kishte vërejtë tek neni 5, ku përcaktohet se provimit mund t'i nënshtrohen vetëm juristët e diplomuar, sipas sistemit 4 vjeçar ose studimeve master, duke i diskriminuar të diplomuarit me sistem 3 vjeçar, kurse një standard i tillë nuk vlen edhe për studentët të cilët kanë kryer studimet e tyre jashtë vendit, dhe të cilët krejt çfarë duhet të bëjnë është të nostrifikojnë diplomat e tyre pranë organeve përkatëse.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për provimin e jurisprudencës.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Ardian Gjini – Deklaroi se ligji në fjalë nuk i plotëson as përafërsisht kushtet për t'u barazuar me atë që ligji e ka për detyrë të rregullojë në sferën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, e që mundëson luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Arsim Bajrami – Tha se, ndonëse ka vërejtje për objektin dhe materien e këtij projektligji, por gjithashtu potencoi se ligji mund të rregullohet dhe mund të formësohet. Ky ligj është një nevojë jo vetëm si rezultat i kërkesës së BE-së, por është një nevojë edhe për rregullimin e brendshëm, sidomos kjo vlen për shtetet e reja në të cilat shkalla e kriminalitetit dhe korrupsionit është shumë e lartë, prandaj ai propozoi që mos të bllokohet ky ligj, pasi ka mundësi që me amendamente t'i ndërrohet titulli, objekti dhe destinimi.

Ardian Gjini – Duke u ndërlidhur me parafolesin, vlerësoi se ligji është i pamundur të përmirësohet, pasi koncepti i tij është i gabuar, prandaj ai propozoi që Komisioni të nxjerrë rekomandim, që ligji të mos kalojë.

Lidhur me procedimin e tij për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare, u votua nga anëtarët e Komisionit dhe votimi ishte i barabartë (për 4, kundër 4 dhe abstenim 1). Edhe pse votimi ishte i barabartë, Komisioni vendosi që Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, t'ia procedojë Kuvendit për shqyrtim në një nga mbledhjet plenare.

Rekomandim

Të shqyrtohet në parim Projektligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës, me amendamentet e propozuara nga grupi i punës

Armend Zemaj – Tha se, si rezultat i punës së grupit të punës, janë bërë ndryshime, siç është ndryshimi i vet titullit të projektligjit dhe ndërhyrjet në një amendament të caktuar, andaj ai ftoi deputetët që t'i përkrahin ndryshimet.

Arsim Bajrami – Duke marrë parasysh se ky është një ligj i barabartë me ligjet e tjera, amendamentet nuk vendosen brenda ligjit, siç e kemi rastin tek ndryshimet kushtetuese, ku amendamenti bëhet pjesë e kushtetutës, prandaj e tëra që duhet bërë është që të futet në gazetën zyrtare dhe të dekretohet nga Presidentja, prandaj kodi penal nuk shfaq ndonjë pengesë në këtë rast.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.

II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës për miratimin e Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37,38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës , me amendamentet e propozuara.

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit riformulohet si vijon: “ **Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082.** “

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 2 i projektligjit, hiqet.

7. Shqyrtimi i propozimit për anëtarë të Këshillit, në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë

Kryetari – I njoftoi anëtarët se në mbledhjen e Komisionit, të mbajtur më 27 gusht 2012, i kemi shqyrtuar propozimet për emërimin e anëtarëve të Këshillit në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas. Komisioni, në këtë mbledhje, kishe përzgjedhur anëtarët nga institucionet e parapara në nenin 11.3, ku nga Ministria e Drejtësisë kishte përzgjedhur kandidatin Emrush Kastrati, për anëtar në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas.

Më vonë jemi njoftuar se kandidati në fjalë, para se propozimi i Komisionit për Legjislacion t'i procedohet seancës plenare, është zgjedhur anëtar edhe në KPM. Ai propozoi të kërkohet nga Komisioni i Ndihmës Juridike që të veprojë në pajtim me ligjin, për ta plotësuar kushtin ligjor me propozime të reja nga Ministria e Drejtësisë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

Kërkohet nga Komisioni i Ndihmës Juridike, që të veprojë në pajtim me nenin 11 të Ligjit për ndihmë juridike falas nr. 04/L-17, për ta plotësuar kushtin ligjor me propozime të reja nga Ministria e Drejtësisë.

8. Të ndryshme

a. Formimi i grupit të punës për Projektligjin për procedurën përmbartimore

Komisioni formoi grupin e punës për shqyrtimin e Projektligjit për procedurën përmbartimore në këtë përbërje:

- Haki Demolli- kryesues,
- Halit Krasniqi- anëtar,
- Albulena Haxhiu- anëtar.

b. Shqyrtimi i detyrave nga Plani veprimit për tremujorin e tretë

Komisioni për Legjislacion, për të vepruar në pajtim me Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2012, për tremujorin e tretë, me qëllim të përmbushjes së detyrave të përcaktuara, ka identifikuar detyrat e veta për tremujorin e tretë dhe vlerësoi se në këtë tremujor, Komisioni nuk është i ngarkuar me asnjë detyrë. Komisioni e shqyrtoi pikën 26 të Planit të veprimit dhe vlerësoi se kjo pikë nuk bie në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion, por në fushëveprimin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Arben Gashi

Stafi Mbështetës i Komisionit.